KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

PROCESVERBAL X/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së X (dhjetë) për vitin 2026 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: **KK Suharekë**
Zyra: **Salla e Bordit të Drejtorëve**
Data: **16.10.2026**
Ora : **10:00**

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Flamur Bytyçi
z.Enver Shabani
znj.Mimoza Bajraktari
znj.Sanie Kuçi Rexhepaj
znj.Laureta Tafaj
z.Dardan Berisha

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes shprehjes së interesit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e tarifes për tregun javor;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për kompensimin e komisionit për zgjedhjen e këshillav lokale;**
7. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësit natyrore;**
8. **Raportimi financiar i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-shtator 2026**
9. **Raport nga DKA-ja**
10. **Raporti i përformances për Komunën e Suharekës për vitin 2025;**

Kryesuesi-Përshendetje për të gjithë para se me hedhë në votim ju njoftoj që me kërkesen e Drejtori të Pronës pikën 3 kemi me terheq prej rendit të ditës dhe njëkohësisht kemi me fut edhe një pikë të rendit ditës shtesë e cila është propozim për mirënjohje për çmimin "Ukë Bytyçi".
Kryesuesi-e hedhë në votim rendin e ditës me pikën shtesë

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin
Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin
Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e tarifes për tregun javor;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin
Avni bytyçi-përshendetje për të gjithë,në "Eko-Theranda" Komuna është aksionare 100% ,e kemi themelu me iniciativen e Kryetarit me vendimin e Kuvendit dhe miratimin e Qeverisë së Kosovës,kur një ndërmarrje publike ka mundësi me kry një shërbim për Autoritetin në këtë rast për Komunën atëhere nënshkruhet kontrata e një anëshme apo arrihet një marrëveshje një anëshme me të cilën i jep të drejtë Kryetarit të komunës me nënshkru,dhe ne e kemi obligimi që ti krijojm kushte që Eko-Theranda të krijoj të hyra vetanake dhe të financohet vetë.Në bazë të rregullores për caktimin e tarifave dhe ngarkesave një tarif të tillë nuk e kemi pas për arsye se deri në qershor të këtij viti tregu javor ka qenë në shfrytëzim nga një operator ekonomik të cilit i ka kalu kontrata dhe Komuna e ka marrë me menaxhu vetë,dhe ne kemi për obligim përmes Asamblesë të caktoj tarifen për qështjen e shërbimeve që kryne ndermarrja publike në raport me fermerë që shesin në treg.
Laureta Tafaj-në mandatin e kalum unë e di opeartori që e ka pas këtë tregun ka pas borxhe shumë,a ka pagu diqka a ka marrë përmbaruesi diqka apo deri tash nuk ka borxh të pagum.
Agim Bylygbashi-përshendetje për të gjithë,jan disa opartor ekonomik që nuk ju kan përmbajtë kontratës dhe borxheve ne veq kemi fillu me marrë masa dhe njëri prej tyre është edhe ai.
Flamur Bytyçi-përshendetje për të gjithë,unë kisha deshtë me pa marrëveshjen nëse e ka nënshkru Kryetari dhe besojë që është mirë me na bashkangjitë në material,e tha edhe Laureta mirpo sa e di unë borxhet kan qenë të akomulume ndërvite nuk ka qenë borxh që është bë kohët e fundit,unë deshta një pyetje për Drejtorin e Financave a rrezikon që Komuna me hup inkasimin e borxhit përshkak që borxhi është i vjetër dhe a kemi ndonjë vlerë sa është borxhi momental?
Agim Bylygbashi-borxhin sakt nuk e di sa është por është e vertetë që është borxh i bartur ndër vite,procedurat që kemi pas mundësi me i ndjek i kemi ndjek.
Flamur Bytyçi-a jan tarifat e njëjta apo kan ndryshu diqka.
Kryesuesi-jan më të ulëta se qe i ka pas operatori ekonomik.
Dardan Berisha-përshendetje për të gjithë,ky projekt-vendim unë mendoj që është i arsyeshëm për arsye që Eko-Theranda deri tash e ka bë edhe mirëmbajtjen e tregut kështu që i jepet kompetencë e plotë,por paraprakisht është dashtë ne me pas një raport të deri tanishëm për punën

dhe aktivitetin që zhvillohen aty dhe me pas edhe punë e tarfiave që mos me u ngrit si diskutim sot diferenca e tarifave sepse ne nuk kemi dit sa kan qen apo sa jan sot.Eko-Theranda a ka me pas parasysh këta tregtarë ambulantor që jan napër rrugë sepse ata po paraqesin probleme apo duhet Drejtoria e Inspeksionit në këtë drejtim me punu,sa i përket borxhit ne e kemi diskutu edhe më herët un e di qe ne si KPF dhe si Asamble ne e kemi marrë një vendim që ai me i kthy borxhet në form të kësteve sepse shuma ka qenë e jashtëzakonshme por nuk e di tash qysh ka vazhdu i njejti. Vendimi është ndoshta i drejtë por paraprakisht është dashtë me ju bashkangjit edhe disa të dhëna të cilat ne nuk i kemi ditë.
Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për kompensimin e komisionit për zgjedhjen e këshillav lokale;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin
Flamur Bytyçi-nëse nuk gaboj unë kërkoj që në qdo komision që bëhet me u pagu dhe nuk e di pse që kjo nuk është bë.
Avni Bytyçi-mandatin e kalum kemi fillu me çështjen e themelimit të këshillave të Fshatrave siq e kërkon udhëzimi administrativ i MAPL-së dhe me thën të drejtën mandatin e kalum nuk e kemi parapa një gjë të till dhe komisioni e ka kry punën pa kompenzim mirpo mbas themelimit të komisionit kan lind kërkesat nga anëtarët e komisionit që të bëhet me pages për arsye që kan shpenzime private duke dalur në teren dhe Kryetari dhe Kryesuesi kan kërku që ti bëjm me pages si komisionet e tjera.
Flamur Bytyçi- i kuptoj kta kolegt që jan pjesë e komisionit dhe un kam fol edhe kur skam qenë pjes e komisionit realisht për mu nuk është pranueshëme që një komision me u pagu për një çshtje që ska të bëj me terenin por është brenda objektit Komunës me këta që dalin ndoshta kjo është mir me u bë për të ardhmen për secilin komision një pages simbolike.
Enver Shabani-përshendetje për të gjithë,përveq me pagu komisionin që është e arsyeshëme dhe e nevojshme unë propozoj që me u pagu edhe Kryetart e Fshatrave me një pag të arsyeshme se e di që ka me pas probleme në vazhdimësi,pse një Kryetar i Fshatit me punu pa pages,pse duhet me i marr pergjegjësi pa kompenzim.
Avni Bytyçi-në bazë të vendimit të Asamblesë edhe në bazë të rregullores për themelimin e kryesis së fshatrave thot që Kuvendi nxerr vendim për kompenzimin,Ekzekutivi e ka pa tëarsyeshëm dhe të nevojshëm që të bën kompenzimin me nga 50€ për takimet kur Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit i thërret në takim me ftesë për një çështje të caktume me bisedu.Nuk mundesh me i kompenzu me pagë si po propozon ti.
Flamur Bytyçi-si Ekzekutiv,si Kryesues sa her i keni thirr Kryetart e Fshatërave në takim a mundemi me dit? Pse nuk e keni bë të paktën 1 her në muaj me i ftu dhe me i kompenzu.
Dardan Berisha-unë jam pro e këtij vendimi por kjo është shumë e pa logjikshme ku anëtarët e komisionit shkojnë dy javë kurse një Kryetar i fshatit jo krejt por jan një 15 Kryetar që bëjnë punë të jashtëzakonshme,dhe unë nuk pajtona me zyrtarin ligjor që thot nuk i ka ftu Kryesuesi dhe Kryetari sepse i ka thirr por ndoshta jo në mënyr zyrtare sepse un i kam pa këtu që kan qenë dhe keni bë foto për disa aktivitete,për qarkorën e par në qershor kush duhet me organziu takimin Kryetari i fshatit si dhe për shumë aktivitete tjera dhe jan në teren dhe për këtë arsye duhet me i stimulu.

Avni Bytyçi-është e vertet ndoshta Kryetari i ka ftu me telefon mirpo në momentin që kërkohet një kompenzim kërkohet letra, ftesa, lista e pjesëmarrjes dhe pa këto kompezimi nuk bëhet, administrata punon me letra.
Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësit natyrore;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin
Dardan Berisha-deshta me diskutu për punen e qative të Shkolles "Migjeni" Gjinocë dhe Shkolla Profesionale "Abdyl Ramaj" në Shirok,në Gjinocë ka fillu ndërtimi mirpo në Shirokë më duket nuk ka fillu ende dhe këto mjete i lëshon Ministria apo sepse është dikun 150.000€.
Nënkryetarja-DKA e ka të nënshkrume memorandumin me Ministrin e Arsimit për Shkollën në Gjinoc dhe 3 Shkollat kështu që nuk ka të bëj me vlerësimin ai është memorandum i veqant që Ministria e ka bë dhe kjo e Shkollës "Abdyl Ramaj" pritet me fillu.
Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 7.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit për ndarjen e çmimit "Ukë Bytyçi"

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin
Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 8. Raportimi financiar i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-shtator 2026

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin
Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 9. Raport nga DKA-ja

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin
Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet
Pika 10. Raporti i përformances për Komunën e Suharekës për vitin 2025;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin
Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi-11:00